

ECO-FISH 1st e-newsletter

Projekti "Gjurmë ekologjike në bujqësinë detare ndërkufitare në Sagiada (Greqi) dhe në jug të Shqipërisë" (ECO-FISH) synon, përmes veprimeve specifike pilot, të zvogëlojë gjurmën mjedisore të akuakulturës në Greqi dhe në Shqipëri, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kontrollin e kushteve mikroklimatike gjatë prodhimit.

Projekti ECO-FISH zbatohet në kuadrin e "Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg IPA II Greqi-Shqipëri 2014-2020" dhe është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe nga Fondet Kombëtare të Greqisë dhe Shqipërisë.

Gjatë muajve të kaluar:

Rezultati 3.1.1 " Raporti i metodave të prodhimit të aplikuar" u finalizua nga Universiteti i Janinës - Përfituesi kryesor i Projektit.

Arsyeja e këtij studimi ishte rritja e kapaciteteve të fermerëve të peshkut në zonën e Sajadhës dhe gjirit të Vlorës, në bazë të bashkëpunimit të ngushtë, trajtimit të problemeve të përbashkëta, shkëmbimit të njohurive dhe sfidave të ardhshme me të cilat ballafaqohet sektori peshkimit. Dokumenti përfshin një përshkrim të detajuar të a) sektorit në secilën zonë; b) proceset e prodhimit dhe pajisjet që lidhen me bujqësinë detare; dhe c) sugjerimet për përmirësim dhe zgjidhjet e mundshme të problemeve dhe çështjet që hasen zakonisht në fermat e peshkut.

*Gjurmë ekologjike
në bujqësinë detare
ndërkufitare*

ECO-FISH



ECO-FISH

Studimi inkurajon perspektivat për zhvillimin e mëtejshëm në nivelet teknologjike dhe të prodhimit, si dhe sfidat kryesore që duhet të trajtohen. Në fund të fundit, të dy rajonet rurale kanë të gjitha parakushtet për të zhvilluar më tej këtë industri me gjurmë të ulët (dmth industria pa oxhaqe), në mënyrë që të prodhojnë ushqime të shëndetshme dhe relativisht të lira, të sigurojnë punësim, të rrisin GDP vendore dhe të përmirësojnë bilancin tregtar të të dy vendeve.

Rezultati 3.2.1 "Studimi Bazë në Zonën Greke" u finalizua nga Dhoma e Tregtisë së Thesprotisë. Ky studim siguron një skanim bazë të dobishëm të gjendjes kombëtare dhe sidomos të zones së Sagiada, Thesproti në aspektin e prodhimeve të detit, numrin e fermave, vëllimet për speciet e kultivuara, trendet e çmimeve, fusha dhe organizimi hapësirave, qarkullimi, eksportet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet sektori i peshkimit, duke konkluduar se:

- Edhe pse sektori kombëtar i peshkimit ende vuan nga çmimet e ulëta, burokracia, konkurrenca nga vendet e treta dhe kriza financiare, duket se vëllimet e prodhimit po rriten gradualisht. Ky trend pritet të vazhdojë pas përfundimit të procesit të ristrukturimit në sektor;
- Kjo situatë pasqyrohet në mënyrë të pashmangshme në sektorin lokal në Sagiada, Thesproti. Megjithatë, perspektivat për zhvillim në të ardhmen janë inkurajuese, veçanërisht pas përcaktimit zyrtar të Zonës lokale të Zhvillimit të Akuakulturës (AODA) në zonen e Sagiada.

Për projektin ECO-FISH gjatë muajve të mëparshëm janë zhvilluar eventet e mëposhtme:

Eventi Lokal në Greqi/Ditë Informuese u mbajt me sukses në Igumenicë të enjten më 14 shkurt 2019, në Qendrën e Konferencave të Dhomës së Tregtisë së Thesprotisë.

Eventi Lokal/Ditë Informuese u organizua nga Dhoma e Thesprotisë në bashkëpunim me Manaxherin e Projektit Prof. Ioannis Skoufos nga Universiteti i Janinës me pjesëmarrjen e ish-Rektorit të TEI të Epirit, Kryetarit të Këshillit të Integrit, Prof. Anastasios Tsinas, Dekanit të Shkollës së



Agrikulturës në Universitetin e Janinës, Prof. Athina Tzora, si dhe nga aktorët lokalë dhe bizneset në sektorin e akuakulturës.

Gjatë eventit ditë informuese, u paraqitën si vijon: korrelacioni midis projektit ECO-FISH dhe qëllimeve të Dhomës së Tregtisë, rëndësinë e Projektit për

planifikimet e Dhomës së Tregtisë për shtimin e vlerës për produktet bujqësore vendore, aktivitetet e projektit dhe rezultatet e pritura, lidhja midis rezultateve të projektit dhe sektorit të akuakulturës.

Ju lutemi gjeni më shumë informacion në linkun: <https://cb-ecofish.eu /2019/02/27/ecofish-project-implemented/>

Eventi Lokal në Shqipëri/ Ditë Informuese u mbajt me sukses në Orikum të premten, më 22 shkurt 2019.






Info day u organizua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Qarku Vlorë në bashkëpunim me dy përfituesit e tjerë shqiptar të Projektit (SEEP, Fondacioni RAF) me pjesëmarrjen e institucioneve të të Qarkut, shoqatave të mjedisit si dhe sipërmarrjeve të qarkut që veprojnë në fushën e akuakulturës.



Ndër çështjet që u diskutuan gjatë eventit Ditë Informuese ishin: lidhja midis projektit ECO-FISH dhe qëllimeve të Dhomës së Tregtisë, rëndësinë e Projektit për planifikimet e Dhomës së Tregtisë për shtimin e vlerës në lidhje me produktet bujqësore vendore, aktivitetet e projektit dhe rezultatet e pritura, lidhja midis rezultateve të projektit dhe sektorit të akuakulturës.

Ju lutemi gjeni më shumë informacion në linkun: <https://cb-ecofish.eu /2019/02/27/ecofish-project-implementation-al/>.

Përfituesit e projektit:

	University of Ioannina, Special Account for Research Funds	LB
	Chamber of Thesprotia	PB2
	Chamber of Commerce and Industry of Vlora Region	PB3
	Social Education & Environnement Protection	PB4
	Royal Albania Foundation	PB5

"Pikëpamjet e shprehura në këtë e-buletin nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, të vendeve pjesëmarrëse dhe të Autoritetit Menaxhues".

Na ndiqni në:

Website: <https://cb-ecofish.eu>

Facebook: Eco - Fish

email: ecofish2016@gmail.com